



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Bujar I. Kabashi” B.I. të datës 22.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Bujar I. Kabashi” B.I. të datës 22.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të publikuar formularin për korigjimin e gabimeve në njoftimeve të publikuara përmes të cilit do të bëj ndryshim/plotësimin e dosjes së tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim dhe në përputhje të plotë me LPP.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Bujar I. Kabashi” B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Bujar I. Kabashi” B.I. (tutje “parashtruesi”) me datë 22.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Të nderuar, kërkesa ISO 50001, është ne kundërshtim me dosjen e tenderit dhe qëllimin e përdorimit. Kjo kërkesë ka të bëjë me Menaxhim të energjisë, që rrjedhimisht si kërkesë është ne kundërshtim me produktet që do të ofrohen dhe dorezohen për këto tender. Pasi që edhe siq citohet; ky standard ISO ofron një mënyrë praktike për të përmirësuar përdorimin e energjisë, nëpërmjet zhvillimit të një sistemi të menaxhimit të energjisë (EnMS). Ky lloj standardi nuk është i detyrueshem për kompanitë e njeherit nuk është as i nevojshem për këto lloj tenderi. Duke qenë se si standard nuk i perket kësaj lëmie kërkojme nga ana e juaj që të eliminohet si kërkesë e dosjes së tenderit, sepse mund të jete favorizues për një apo më shumë kompani dhe eliminon konkurrencën e hapur. Me këto kërkesë për Rishqyrtim, kërkojme gjithashtu nga AK, duke qenë se janë kërkuar të dorezohen mostrat dhe sic dihet ofrimi i tyre ka kosto, kërkojme nga ana e juaj të na informoni sa lloje të mostrave duhet të dorezohen para afatit të fundit për dorezimin e tenderit. Gjithashtu, kërkojme nga AK që të bëjë zgjatjen e periudhës së dorezimit, për vet faktin që të na mundësohet ofrimi i mostrave për këto tender”.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet pretendimi ankimor është kërkesë në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - 9.1 & 9.2) e cila është përcaktuar si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<u>Kapaciteti teknik dhe profesional</u> Operatori Ekonomik duhet të ofroj ISO standardet nga prodhuesi ISO 9001, ISO 14001, ISO 50001.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Kopje të Iso sandardeve me afat të vlefshmerise Iso 9001, Iso 14001, ISO 50001.
---	-----------	--	---

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësi kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë 23.08.2023 njësi kërkuese ka dërguar përgjigjet si në vijim:

1. *“Sa i perket standardit të kërkuar ISO 50001 largohet nga kërkesa”.*
2. *“Sa i perket mostrave është kërkuar që të dorezohen për pozicionet 1, 2, 3, 4 nga një mostër sipas psecifikave”.*
3. *“Kurse zgjajta e periudhës së afateve është ne kompetence të juaj”.*

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese. Rrjedhimisht është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të pjesërisht të bazuara. Konkretisht është gjetur se pretendimi ankimor për të larguar kërkesën lidhur me certifikatën ISO 50001 është pretendim i bazuar ndërsa pretendimet tjera ankimore janë të pabazuara.

Megjithatë sa i përket pretendimit ankimor sipas të cilës kërkohet shtyerja e afatit për dorëzimin e ofertave, duhet cekur se me rastin e publikimit të formularit për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara në mënyrë ky fakt njëkohësisht nënkuptohet edhe shtyerjen e afatit për dorëzimin e ofertave në kuptim të nenit 24 paragrafit 24.7 të RRPP. Shtyerja e afatit për dorëzimin e ofertave në këtë mënyrë konsiston që të jetë në përputhje edhe me kërkesën e parashtruesit sipas pretendimeve ankimore të tij.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.